



**INSTITUTI I HISTORISË  
"ALI HADRI"**

Nr. 01/175/25 prot.  
Tiranë, më 22.12.2025



**INSTITUTI I STUDIMEVE  
PËR KRIMET DHE PASOJAT  
E KOMUNIZIMIT**

Nr. 371 prot.  
Tiranë, më 18.12.2025

### **MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

I lidhur sot më datë . . . .2025 midis palëve:

**Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri**, Institut i pavarur publik me qendër në Tiranë, me NIPT L11618454G, me seli në adresën: Rruga "e Saracëve", i përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv **Z. Çelo Hoxha**, më poshtë cilësuar si "ISKK".

Dhe

**Instituti i Historisë "Ali Hadri"**, institucion kërkimor - shkencor publik me seli në Rrugën "Eqrem Cabej" Prishtinë, përfaqësuar nga Drejtoresha Znj. Teuta Shala-Peli.

Palët me mirëkuptim midis tyre, lidhin këtë marrëveshje si më poshtë vijon:

#### **NENI 1**

#### **OBJEKTI**

Qëllimi i këtij Memorandumi është krijimi i një kuadri të formalizuar bashkëpunimi ndërmjet Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (ISKK) dhe Institutit të Historisë, në fushat e kërkimit shkencor, edukimit, botimeve dhe projekteve të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Aktivitetet e parashikuara në këtë Memorandum synojnë informimin

dhe sensibilizimin e publikut mbi pasojat e regjimit komunist, duke mundësuar një analizë të thelluar të ndikimeve historike dhe sociale të kësaj periudhe.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Palët angazhohen të zhvillojnë dhe të realizojnë aktivitete të përbashkëta, përfshirë seminare, konferenca shkencore, ekspozita, prezantime publike dhe veprimtari të tjera akademike e kulturore, me qëllim ruajtjen, dokumentimin dhe promovimin e kujtesës historike të periudhës së komunizmit, si dhe edukimin e brezave të rinj mbi rëndësinë e këtyre zhvillimeve historike.

## **NENI 2**

### **BAZA LIGJORE**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në: Ligjin nr.10 242 datë 25.02.2010 “Për Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri” neni 5 gerat “f”, “h”, “i”, dhe Kodin Civil.

## **NENI 3**

### **ANGAZHIMET E PALEVE**

1. Palët do të organizojnë dhe marrin pjese ne konferenca, seminare dhe aktivitete të përbashkëta.
2. Palët mund të organizojnë gjithashtu seminare, konferenca dhe aktivitete kulturore/sociale, që do të kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të përbashkëta të këtij bashkëpunimi.
3. Palët angazhohen gjithashtu për organizimin e aktiviteteve edukative dhe kulturore, përfshirë zhvillimin e ekspozitave, leksioneve dhe aktiviteteve të tjera, që mund të realizohen individualisht ose në bashkëpunim me institucione lokale.
4. Bashkëpunimi do të përfshijë shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin e projekteve arsimore dhe kërkimore, me synimin për të kontribuar në përmirësimin e kapaciteteve dhe njohurive në fushat përkatëse.

## **NENI 4**

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

1. Cdo rregullim ose ndryshim në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi bëhet vetëm në formë të shkruar dhe nëpërmjet pëlqimit reciprok të palëve, dhe nuk shoqërohet me kosto financiare.

2. Cdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.
3. Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje, nga të cilat 3 (tre) kopje për ISKK-në , 1 (një) për Institutin.

## NENI 5

### HYRJA NE FUQI

Kjo marrëveshje hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit të saj nga palët dhe do të jetë me afat të pacaktuar.

**PËR ISKK**  
**DREJTORI EKZEKUTIV**  
**CELO HOXHA**



**PËR INSTITUTIN E HISTORISË**

**DREJTORI**  
**TEUTA SHALA-PELI**

